



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 19 Shkurt 2022

Nr: 89

VENDIM

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 9, DATË 25.1.2022, TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE, "PËR MIRATIMIN E SASISË SË VULAVE REZERVË TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT QË DO TË PRODHOHEN PËR ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE TË DATËS 6 MARS 2022"

Në mbështetje të Dekretit nr. 13438, datë 20.01.2022, të Presidentit të Republikës "Për caktimin e datës së Zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore", të nenit 19, pikat 1, shkronja "n", dhe 2, nenit 103, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" dhe të vendimit nr.11, datë 28.12.2020, të Komisionit Rregullator, "Për caktimin e rregullave për administrimin dhe shpërndarjen e vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit" të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I:

1. Pika 1 e vendimit nr. 9 datë 25.01.2022, ndryshohet si më poshtë vijon::
"1. Për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, të prodhohen 50 (pesëdhjetë) vulat rezervë të KQV-së."
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 19 Shkurt 2022

Nr. 89

"Për një ndryshim në vendimin nr. 9, datë 25.1.2022, të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për miratimin e sasisë së vulave rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit që do të prodhohen për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022"